



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD.nr.1/2022

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, U.D. Kryetari i Gjykatës Artan Sejrani, në çështjen e hetimit disiplinor, duke vepruar sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 18.01.2022 e parashtruar nga L.Q.-Z., nga, ndaj gjyqtarit A.B., me datë 11.02.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa e L.Q.-Z., nga, e parashtruar me datën 18.01.2022, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B.,.

A r s y e t i m

Parashtruesja e kërkesës L.Q.-Z., me datën 18.01.2022 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B., në kërkesën e saj ka theksuar se gjyqtari A.B., në lëndën C.nr....., në Gjykatën Themelore në Prizren nga data 14 janar 2019 nuk na ka ftuar asnjëherë në seancë gjyqësore sipas padisë C.nr.,....., duke bërë zvarritje të procedurës dhe njëherit diskriminimin gjinor për arsye se e paditura, më ka eliminuar nga thirrja si palë në marrëveshjen e kredisë me nr. E.nr....., ku unë figuroj si palë në rastin e nënshkrimit të marrëveshjes kreditore duke mos na ftuar asnjëherë në procedurat përmbarimore të përmbaruesit privat Gj.R., në lëndën P.nr.....,

Gjyqtari A.B., me parashtrësë të veçantë ka përkthuar ka theksuar se kjo lëndë është dorëzuar në Gjykatë në dhjetor 2019, nuk i ka plotësuar kushtet që të merret në punë së pari kjo lëndë nuk hynë në lëndët nga fusha civile të cilave ligji iu jep përparësi, dhe duke pas parasysh se në punë kemi lëndë të vjetra deri më tani nuk e ka marr asnjë veprim në këtë lëndë përveç vendimit për propozimin për caktimin e masës së përkohshme.

U.D. Kryetari i Gjykatës pas hetimit paraprak, shikimit në shkresat e lëndës penale C.nr....., analizimit të kërkesës së parashtrueses, deklaratës së gjyqtarit të çështjes, konstaton se kërkesa është e pa bazuar.

U.D. Kryetari i gjykatës fillimisht konstaton parashtruesja kërkesës në këtë lëndë është në cilësi të paditëses sipas padisë, për shkak të anulimit të marrëveshjes së kredisë ndaj të paditurës (.....). Gjyqtari i çështjes siç shihet nga shkresat e lëndës, ka marrë veprime duke vepruar sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme dhe me datën 20 janar 2020 të njëjtën e ka refuzuar.

U.D. Kryetari i gjykatës lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë, në ankesën e saj parashtruesja, ka theksuar se në lëndën kontestimore gjyqtari është duke bërë zvarritje të procedurës dhe diskriminim gjinor. Në ankesën e saj nuk ka përmendur ndonjë rrethanë apo shkelje të caktuar të gjyqtari së rastit ashtu siç kërkohet edhe me dispozitat ligjore në fuqi të ligjit nr. 06/1-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në ankesën e saj nuk ka bërë një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për Shkelje disiplinore kundër gjyqtarit në fjalë por ka shprehur pakënaqësi lidhur me zvarritjen e procedurës. Mirëpo sipas shkresave të lëndës del se në vitin 2020 është vendosur në lidhje me masën e përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë ndërsa lënda pritet të hyjë në gjykim sipas radhës së shqyrtimit duke pas parasysh se kjo lëndë nuk është e natyrës së lëndëve që kanë prioritet andaj edhe nuk mund të tejkalohen lëndët sepse në çdo rast do të cenohej trajtimi i barabartë i qytetarëve para ligjit e veçanërisht para Gjykatës.

Andaj siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 9 par.6 lidhur me nenin 17 par.5 të ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
AD.nr.1/2022 datë 11.02.2022

22



Kundër këtij aktvendimi nuk parashihet e drejta e ankesës.